



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1685, datë 19.09.2011

Për

“Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Unifi Holdings Inc. Dega në Shqipëri dhe Altelecom sh.a”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 19.09.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brëndshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Unifi Holdings Inc. Dega në Shqipëri dhe Altelecom sh.a

BAZA LIGJORE:

1. Neni 49, neni 50 pika 1, neni 60 dhe neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Neni 46 e vijues të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore nr. 18 “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore nr. 19 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;

5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008,

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa e sipërmarrësit Unifi Holdings Inc. Dega në Shqipëri nr. 988 Prot., i AKEP, datë 21.06.2011, “*Kërkesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Unifi Holdings Inc Dega Shqipëri dhe Albtelecom sh.a.*”;
- Shkresa e Unifi Holdings Inc. Dega në Shqipëri datë 12.04.2011 “*Kërkesë për lidhje marrëveshje interkoneksioni-dërgimi i ofertës referencë të marrëveshjes dhe termat teknikë*”;
- Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**);
- si dhe, duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

Unifi Holdings Inc. Dega në Shqipëri (këtu e mëposhtë Unifi) , me shkresën nr. 988 prot, datë 21.06.2011 “*Kërkesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Unifi Holdings Inc Dega Shqipëri dhe Albtelecom sh.a.*”, sqaron se:

1. Unifi në cilësinë e operatorit të komunikimeve elektronike që ka njoftuar ofrimin e rrjetit të komunikimeve elektronike dhe është regjistruar në Shqipëri bazuar në Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “*Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë*”, ka të drejtën e lidhjes së marrëveshjes së interkoneksionit me Albtelecom sh.a, në zbatim të:
 - Vendimit nr.1348, datë 26.07.2010 sipas të cilit Albtelecom ka detyrimin e mosdiskriminimit, detyrimin për Akses dhe interkoneksion, si dhe të përdorimitin e përbashkët të faciliteteve të rrjetit sipas nenit 42 të Ligjit nr. 9918;
 - Nenit 47 të Ligjit nr. 9918 i cili parashikon detyrimin e çdo operatori dhe rrjeteve dhe ose shërbimeve të komunikimeve elektronike për t’u dhënë një ofertë interkoneksioni operatorëve të tjerë të rrjeteve dhe ose të shërbimeve elektronike, për të siguruar komunikimin e përdoruesve, ofrimin e shërbimeve të komunikimeve;
 - Neneve 4.1, 4.03, 4.4, 4.5, 4.6, neneve 5.1, 5.6, nenit 6 dhe 7 të Rregullores për Akses dhe Interkoneksion
2. Unifi bën me dije se, me anë të shkresës datë 12.04.2011 ka shprehur interes për të shkëmbyer trafik telefonik zanor me Albtelecom sh.a, por Albtelecom nuk ka kthyer asnjë përgjigje lidhur me kushtet apo informacionin teknik që Albtelecom ka nevojë për lidhjen e një marrëveshje interkoneksioni me Unifi;
3. Për sa më sipër Unifi, në zbatim të nenit 50 të Ligjit nr. 9918 datë 19.05.208 kërkon nga AKEP, të marrë në shqyrtim kërkesën e Unifi dhe pas këtij procesi të urdhërojë Albtelecom të lidhë brenda afateve sa më optimale, një marrëveshje kombëtare interkoneksioni me Unifi;

4. Duke qënë se, sipërmarrësit Unifi Holdings Inc Dega në Shqipëri dhe Altelecom sh.a megjithë negociatat dhe përpjekjet e bëra, nuk kanë arritur të bien dakord për nënshkrimin e marrëveshjes së interkoneksionit, AKEP në zbatim të nenit 50 dhe në vijim të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” zgjidhja e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve mund të kryhet në bazë të kërkesës së një sipërmarrësi apo me inisiativën e AKEP,

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të Ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brëndshme,

V E N D O S:

1. Të fillojë procedimim administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Unifi Holdings Inc. Dega në Shqipëri dhe Altelecom sh.a.;
 2. Të ngrihet komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me përbërje si:
 - Altin RRAPAJ Kryetar
 - Jetmir BRAHA Anëtar
 - Donald SHTREPI Anëtar
 - Ded JAKAJ Anëtar
 - Esmeralda DERVISHI Anëtar
 3. Të njoftohen palët e interesuara Unifi Holdings Inc. Dega në Shqipëri dhe Altelecom sh.a. për fillimin e procedimit administrativ;
 4. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit;
 5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al
- Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Zamira NURÇE**